



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1338/ 10prot.

Datë 03.06.2026

V E N D I M

Nr. 748/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.659/2026, datë 18.05.2026 për procedurën e prokurimit, “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83072-04-23-2026, me objekt “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre”, me fond limit 6,680,016.00 Lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05-05-2026 , nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k, Nipt L82428011G, me adresë: *Njësia Administrative nr. 10, Rruga "Fortuzi", Nr. 66/1.*
- Autoriteti Kontraktor:** Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane, me adresë: *Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 18.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 659/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint technologies” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83072-04-23-2026, me objekt “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre”, me fond limit 6,680,016.00 Lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05-05-2026, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Blueprint technologies” shpk.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2458/16 prot., datë 22.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1338/7 prot., date 25.05.2026, autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë, njofton se ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit si dhe gjithashtu në vijim kërkon heqjen e pezullimit për procedurën objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 2458/16 prot., datë 22.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1338/7 prot., date 25.05.2026, autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë, njofton se ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit si dhe gjithashtu në vijim kërkon heqjen e pezullimit për procedurën objekt ankimi.

II.2. Nga verifikimi i sitemit elektronik si dhe referuar dokumentacionit të ardhur pranë KPP –së, 2458/16 prot., datë 22.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1338/7 prot., date 25.05.2026 autoriteti kontraktor, rezulton se ka modifikuar dokumentat standarte të tenderit si dhe gjithashtu i ka publikuar në sistemin elektronik.

II.3. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr.659/2026, datë 18.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt ankimi “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83072-04-23-2026, me objekt “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre”, me fond limit 6,680,016.00 Lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05-05-2026 , nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

- 1.Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83072-04-23-2026, me objekt “Blerje toner dhe pjesë për pajisjet e printimit dhe mirëmbajtja e tyre”, me fond limit 6,680,016.00 Lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05-05-2026 , nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro